

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**  
**( TË SHOQËRISË "PRASINO LADI" SH.P.K)**

Sot, më datë 05.05.2022, ne ambientet e subjektit Prasino Ladi shpk u realizua takimi midis paleve duke qene prezent:

**SHITESI:**

**Thoma MARKO**, atësia Vasil, amësia Liljana, shtetas Shqiptar, lindur në Pogradec dhe banues në TIRANË, me adresë Xhon Kenedi 03910155; Nd. 4; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 12/10/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 034709691 dhe nr. personal I21012150K, **zoteruese e 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 25.025.385.000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "PRASINO LADI" .**

**Jep pelqimin bashkeshortja e pales shitese**

**Znj Gerta MARKO**, atësia Gafur, amësia Myrvete, shtetase Shqiptare, lindur në Pogradec dhe banuese në TIRANË, me adresë Xhon Kenedi 03910155; Nd. 4; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 15/03/1988, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 034468309 dhe nr. personal I85315091U, .

**BLERESI:**

**AGIM BALAJ**, atësia Jashar, amësia Gjylshah, shtetas Belg, lindur ne Bruksel dhe banues në Belgjike , adresa e banimit : Vroonweg 23,1850 Grimbergen Belgique ,lindur më 03/12/1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Leternjoftim Belg ID nr. 593-0141932-81.

**RIFAT BALAJ**, atësia Haki, amësia Sanije, shtetas Belg, lindur në KOSOVE dhe banues në Belgjike,adresa e banimit: Hortensiastraat 10,1800 Vilvoorde Belgique, lindur më 22/08/1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim Belg ID nr. 595-0692927-74

Pala blerese deklarojne se flasin dhe lexojne shume mire gjuhen shqipe.

Pasi palet verifikuan statusin ligjor te identifikimit te tyre ,deklarojne se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord per redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "PRASINO LADI " Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**BAZA LIGJORE**

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Shitesi **Z. THOMA MARKO**, zoterues i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme **25.025.385,00 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise** Sipas dokumentacionit te depozituar prane QKB-se dhe ndryshimeve te pasqyruara ne skeden e shoqerise kapitali i shoqerise eshte **25.025.385,00 leke**, i zoteruar nga ortaku i shoqerise:

**NENI 1**

**OBJEKTI I KONTRATES**

- 1- **Shites, Z.THOMA MARKO, ortak i shoqerise "PRASINO LADI" shpk, ne kete kontrate transferon nepermjet shitjes, 1 kuote qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise "PRASINO LADI" SHPK dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 12.512.692,5 leke ne favor te personit te interesuar z. Agim Balaj, me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe Statutit te Shoqerise.**



Fq. 1

- 2- **Shites, Z.THOMA MARKO, ortak i shoqerise "PRASINO LADI" shpk**, ne kete kontrate **transferon nepermjet shitjes**, 1 kuote qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise "PRASINO LADI" SHPK dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme **12.512.692,5 leke** ne favor te personit te interesuar z. Rifat Balaj, me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe Statutit te Shoqerise.
- 3- **Pas transferimit me ane te shitjes numri i kuotave do te ndryshoje nga 1 kuote qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise me vlere 25.025.385,00 leke, ne 2 kuota qe perbejne secila 50% te kapitalit themeltar te shoqerise me vlere secila 12.512.692,5 leke .**

## **NENI 2**

### **ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS**

- 1- Shitesi **THOMA MARKO** deklaron se **cmimi i shitjes se kuotes** qe po transferohet te Z. Agim Balaj, nepermjet kesaj kontrate eshte 35.000 euro (tridhjetë e pese mije euro).
- 2- Shitesi **THOMA MARKO** deklaron se **cmimi i shitjes se kuotes** qe po transferohet te Z. Rifat Balaj, nepermjet kesaj kontrate eshte 35.000 euro (tridhjetë e pese mije euro).

#### **Ne total vlere e shitjes se kuotave eshte 70.000 euro (shtatedhjetë mije euro)**

Shitesi konfirmon faktin e mesiperme dhe deklaron se fondet do te transferohen ne llogarine bankare te pales shiteses ne momentin e ndryshimit te pronesisë ne QKB .

Shitesi dhe Bleresi deklarojne se nuk kane asnje pretendim aktual ndaj njeri tjetrit ne lidhje me cmimin e shitjes.

Palet deklarojne dhe pranojne qe depozitimi i kesaj kontrate prane QKB-se do te behet nga pala shiteses ose nje perfaqesues me autorizim nga pala shiteses .

## **NENI 3**

### **GARANCITE**

Shitesi posedon kuotat e lira nga cdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pageses, barre mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokure apo angazhime te tjera te cdo lloj natyre.

Nenshkrimi i kesaj kontrate nga shitesi dhe plotesimi i kushteve te saj nuk perbejne shkelje apo jane ne kundërshtim me normat e (i) statutit te shoqerise, (ii) ndonje gjykim apo urdher, vendim gjyqsor, dekreti apo vendimi te cdo autoriteti vendas apo te huaj subjekt i te cilit eshte shitesi, (iii) ndonje marreveshje, licence apo angazhim ne te cilin keta shites apo shoqeria eshte pale, qe do te cenonte aftesine e tij per te nenshkuar kete kontrate apo per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshem

Bleresit deklarojne se paraprakisht kane verifikuar gjendjen financiare te shoqerise dhe kane dijeni te plote ne lidhje me detyrimet, gjendjen e saj financiare si dhe Pasqyrat Financiare te shoqerise dhe deklarojne se njohin dhe pranon te blejne kuotat e mesiperme me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka ne perpjestim me perqindjen e kuotave, duke mos pasur asnje pretendim nga shitesit per periudhen qe ka qene ortak tani dhe ne te ardhmen.

Palet deklarojne dhe pranojne se pas regjistrimit te kesaj kontrate ne QKB, ne favor te pales blerese, ky i fundit do te ndryshoje emrin e shoqerise nga „Prasino Ladi“ ne „OLEUM ALB“.

## **NENI 4**

### **TE NDRYSHME**

Pas realizimit te ketij transferimi nepermjet shitjes me nenshkrimin e kesaj kontrate **bleresit Z. Agim Balaj dhe Z. Rifat Balaj** behen zoterues te plote dhe te ligjshem te shoqerise " PRASINO LADI " shpk, si me poshte:  
Ortak te shoqerise behen :

- 1- **Z. Agim Balaj**, zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme **12.512.692,5 leke** , qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise " PRASINO LADI " shpk,
- 2- **Z. Rifat Balaj**, zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme **12.512.692,5 leke** , qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise " PRASINO LADI " shpk



## NENI 6

### Forca Madhore

Mospërmbushja e kesaj kontrate nga njera pale nuk do te konsiderohet si shkelje e kesaj kontrate per sa kohe qe mospërmbushja vjen si pasoje e nje ngjarje te konsideruar si force madhore, ne rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te permbushur kushtet dhe afatet e kesaj kontrate dhe (b) ka informuar palen tjetere ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje, Force Madhore do te konsiderohet cdo urdher, rregullore, direktive e qeverise e shpallur ne formen e ligjit apo ne nje forme tjetere, apo cdo lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, trazire, kryengritje popullore, luftime (e deklaruar apo jo) aksione terroriste apo guerrilase te grupeve apo individeve te vecante, grevave apo shqetesime te tjera te kesaj natyre, zjarre, termete apo cdo lloj shkakut tjetere qe nuk varet nga vullneti i paleve ose nuk vjen si pasoje e neglizhences se tyre qe ata nuk kishin mundesi ta parashikonin.

Cdo periudhe kohe brenda se ciles njera prej paleve, bazuar ne kete kontrate do te ndermarr ndonje veprim do te zgjatet ne nje menyre te barabarte me periudhen e kohes ne te cilen pala e kishte te pa mundur te vepronte si pasoje e Forces Madhore.

Ne rastet kur ngjarja e Forces Madhore zgjaten me shume se tre muaj rresht, secila pale mund ta zgjidhe ne menyre te njeanshme kete kontrate, pa asnje penalitet.

## NENI 7

### ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 02, datë 05.05.2022


- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "PRASINO LADI" Sh.p.k.. datë 05.05.2022
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga palet, në prani të Palëve kontraktuese; të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë kontratën.

### PALËT KONTRAKTUESE

SHITESI

Thoma MARKO



Jep pelqimin bashkshortja

Znj. Gerta MARKO

Gerta Marko



BLERESI

AGIM BALAJ

AGIM BALAJ



RIFAT BALAJ

RIFAT BALAJ



**SHOQERIA "PRASINO LADI" SHPK**  
**NUIS L71910018H**  
**Selia Durres Rruga Ali Pashe Tepelena lagjja 14, NP 1/45-ND, ZK 8515 .**

**VENDIM Nr. 02, I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE**  
**"PRASINO LADI" SHPK**  
**Date 05.05.2022**

Ne Seline e shoqerise, u zhvillua mbledhja e Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve te SHOQERISE "PRASINO LADI" SHPK, person juridik shqiptar, rregjistruar ne QKB me date 30.06.2017, me NUIS L71910018H, me seli ne Durres, me pjesmarrjen e ortakut te saj:

**Thoma Marko i datelindjes 12.10.1982, lindur ne Pogradec dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin ID Nr personal I21012150K, zoteruese e 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 25.025.385.000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise,**

Asambleja eshte thirrur rregullisht dhe eshte e afte te marre vendime te vlefshme lidhur me rendin e dites si me poshte vijon:

- Shqyrtimi i kerkeses se ortakut **Z. Thoma Marko**, per shitjen (transferimin) e 1 kuote, qe perben 50% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, kundrejt vleres 35.000 euro, tek personi i interesuar **Z. Agim Balaj**.
- Shqyrtimi i kerkeses se ortakut **Z. Thoma Marko**, per shitjen (transferimin) e 1 kuote, qe perben 50% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, kundrejt vleres 35.000 euro, tek personi i interesuar **Z. Rifat Balaj**,
- Shqyrtimi i kerkeses se ortakut shkarkimit nga detyra te Administratorit **Z. Thoma MARKO** dhe emerimin e administratorit te ri **Z. Agim Balaj** per nje afat kohor 5 vjecar.

Te gjitha te dhenat e tjera te shoqerise mbeten te pandryshuara.

Pas diskutimit te ceshtjeve Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, ne perfundim, pas shqyrtimit te rendit te dites, mbeshtetur ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit » dhe ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare », me ndryshimet perkates, miratoi me unanimitet te plote vendimet e meposhtme.

Pas diskutimit te ceshtjeve Asambleja e ortakëve miratoi me unanimitet te plote vendimin e meposhtem:

- Shqyrtimi i kerkeses se ortakut **Z. Thoma Marko**, per shitjen (transferimin) e 1 kuote, qe perben 50% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, kundrejt vleres 35.000 euro, tek personi i interesuar **Z. Agim Balaj**.
- Shqyrtimi i kerkeses se ortakut **Z. Thoma Marko**, per shitjen (transferimin) e 1 kuote, qe perben 50% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, kundrejt vleres 35.000 euro, tek personi i interesuar **Z. Rifat Balaj**,
- Shqyrtimi i kerkeses se ortakut shkarkimit nga detyra te Administratorit **Z. Thoma Marko** dhe emerimin e Adiministratorit te ri **Z. Agim Balaj** per nje afat kohor 5 vjecar.

Me nenshkrimin e vendimit, te Ortakut te vetem te Shoqerise dhe kontrates se shitjes se kuotave, ortake te shoqerise behen :



- 1- **Z. Agim Balaj**, zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 35.000 euro, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise " PRASINO LADI" shpk,
- 2- **Z. Rifat Balaj**, zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 35.000 euro, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise " PRASINO LADI" shpk

Autorizohet Z. Thoma Marko te depozitoje e te ndjeke procedurat ligjore per depozitim e ketij vendimi dhe kontraten e shitjes se kuotave, prane QKB per te pasqyruar ndryshimet e mesiperme ne skeden e shoqerise, sipas ligjit 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe ligjit 9723, datë 3.5.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ky vendim ortaku u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim e nenshkruan rregullisht ate duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të ciles do te vertetohet ne dokumenta bashkelidhur dhe nga noteri.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "PRASINO LADI" SHPK  
THOMA MARKO**